

VENDIM
Nr.753, datë 6.12.2005

PËR DHËNIE FONDI NDIHME REPUBLIKËS ISLAMIKE TË PAKISTANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të nenit 6 të ligjit nr. 9095, datë 3.7. 2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr. 9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Republikës Islamike të Pakistanit t’i jepet fondi prej 5 210 000 (pesë milionë e dyqind e dhjetë mijë) lekësh, si ndihmë financiare për përballimin e pasojave të shkaktuara nga tërmeti i datës 8 tetor 2005.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha